




Platforma Regionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të  
Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve  
Western Balkan's Regional Platform for Advocating  
Media Freedom and Journalists' Safety



This project is funded by  
The European Union

# Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [KOSOVA]

## PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE





**Treguesit e nivelit  
të lirisë së mediave  
dhe sigurisë së  
gazetarëve  
[KOSOVA]**

PËRMBLEDHJA E TË GJETURAVE

**Autor: Petrit Çollaku  
Dhjetor 2016**

*Titulli origjinal*

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve (Kosova) - Përmbledhja e të gjeturave

*Botuesi*

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



*Autor*

Petrit Çollaku

*Redaktor*

Natyra Avdiu

*Lektor*

Florian Agalli

*Tirazhi*

100 copë

*Dizajni*

comma | communications design

<b>Përmbledhja ekzekutive</b>	<b>5</b>
Qëllimet e projektit dhe metodologjia e hulumtimit	5
Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve	6
Treguesit B: Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës	7
Treguesit C: Siguria e gazetarëve	7
Rekomandime	8
<b>Pasqyrë e treguesve: Për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin perëndimor</b>	<b>9</b>
<b>A. Mbrojtja ligjore e lirisë së mediave dhe gazetarëve</b>	<b>10</b>
<b>B. Pozita e gazetarëve nëpër redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës</b>	<b>17</b>
<b>C. Siguria e gazetarëve</b>	<b>21</b>



## Qëllimet e projektit dhe metodologjia e hulumtimit

Ky raport paraqet rezultatet e hulumtimit të kryer në kuadër të projektit rajonal *Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për avokim për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve*<sup>1</sup>, i cili zbatohet nga shoqatat kombëtare të gazetarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Objektivi kryesor i hulumtimit ishte sigurimi i vlerësimit bazë dhe dëshmime mbi nivelin e lirive të mediave dhe sigurisë së gazetarëve, që do të përdoren më tej në një mekanizëm rajonal për monitorim dhe avokim për liritë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal.

Studimi u realizua nga një ekip hulumtues rajonal, i përbërë nga një drejtues<sup>2</sup> dhe pesë hulumtues në nivel vendi, të emëruar nga shoqatat kombëtare të gazetarëve. Hulumtimi në Kosovë u realizua nga Petrit Çollaku, në bazë të një metodologjie të përbashkët për të pesta vendet. U përdor një gamë e metodave të ndryshme kualitative dhe kuantitative për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave:

<sup>1</sup> Projekti është financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2014-2015, Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.

<sup>2</sup> Ekipi hulumtues u kryesua nga Dr. Snezana Trpevska, eksperte e ligjit për media dhe metodologjisë së hulumtimit.

- *Analiza cilësore e dokumenteve (ACD) e studimeve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademike, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe mbulimit mediatic (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).*
- *Intervistat cilësore me 14 individë (gazetarë, juristë, ekspertë të mediave, përfaqësues të institucioneve publike ose OJQ).*
- *Anketa me 50<sup>3</sup> gazetarë nga organizata të ndryshme mediatike mbi bazën e një pyetësori të strukturuar, të zhvilluar në kuadër të hulumtimit "Bota e Gazetarisë"<sup>4</sup>.*
- *Të dhëna zyrtare statistikore të kërkuara nga institucionet publike ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.*

Pavarësisht përmirësimeve marginale, situata e përgjithshme në lidhje me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve vazhdon të jetë e ndjeshme në Kosovë. Gazetarët vazhdojnë të kërcënohen dhe të sulmohen fizikisht, ndërsa qasja e sistemit të drejtësisë për trajtimin e rasteve të gazetarëve në mënyrë efektive është ende sfiduese.

## Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve

Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e mediave. Veç saj, ka disa akte të tjera legjislative që rregullojnë punën e gazetarëve dhe të mediave. Korniza ligjore e mediave konsiderohet se përmblodh garancitë dhe normat kryesore që mbrojnë lirinë e shprehjes, edhe pse zbatimi në praktikë mbetet i dobët (Seksioni A.1).

Teksa kuadri ligjor ofron garanci për lirinë e shprehjes, mediave dhe informacionit, vlerësimi i përgjithshëm i të gjithë gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar është se zbatimi i garancive të tilla ligjore është i dobët. Një nga ar-

syet e cituara për këtë, është reagimi i ngadaltë i sistemit të drejtësisë edhe në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Gjithashtu, disa institucione shtetërore nuk e kanë parë të arsyeshme që në takimet publike të hartimit të rregulloreve të reja që merren me komunikimin publik ta ftojë edhe AGK-në. Këto raste janë veçanërisht të rëndësishme për shkak të lëndës së rregullave të propozuara, por mungesa e transparencës së institucioneve shtetërore të Kosovës ka rezultuar në përjashtimin e kontributeve të vlefshme për një proces të rëndësishëm, jovetëm për gazetarët, por për interesin publik në tërësi. AGK u rekomandon institucioneve publike të sigurojnë hapësirë për bashkëpunim me komunitetin e gazetarëve, kur të jetë në pyetje legjislacioni i mediave në të ardhmen. (Seksioni A.1, faqe 12).

Institucionet publike në Kosovë u sigurojnë mediave sasinë më të madhe të të ardhurave nga reklamat. Sigurimi i kontratave me institucionet publike ndikon në politikën editoriale të mediave. Megjithatë, Ministria e Financave nuk ishte në gjendje të tregonte me statistika ku kanë shpenzuar më shumë institucionet. Megjithatë, disa ministri raportuan në lidhje me shpenzimet e tyre për shpallje në shtyp dhe media online. (Seksioni A.1, faqe 14).

Së fundmi, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), transmetuesi publik, është përballur me një numër sfidash. Njëra prej tyre ka të bëjë me mosmarrëveshjet mbi financimin, e tjera lidhet me përdorimin e ndërtesave të caktuara. Për më tepër, është e rëndësishme që RTK, për shkak të raportimit jo konfrontues, sidomos për ata që janë në qeveri, është kritikuar publikisht për mungesën e pavarësisë editoriale dhe ndërhyrjen e politikës. Në të njëjtën kohë, RTK ka qenë edhe shënjestra e sulmeve me granata dorë gushtin e kaluar, një në ndërtesën e televizionit dhe një tjetër në shtëpinë e Drejtorit Gjeneral. (Seksioni A.1, faqe 14).

Vitet e fundit, legjislacioni i Kosovës ka pasur disa zhvillime. Në veçanti, u mor një vendim i rëndësishëm për t'iu bashkuar pjesës tjetër të vendeve të rajonit në dekriminalizimin e shpifjes. Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes i vitit 2012 nuk konsiderohet se siguron mbrojtje të zgjeruar për të mirën e zyrtarëve shtetërorë. Ligji nuk është testuar si duhet nga ana e gjykatave, ndërkohë që shumë padi janë në pritje të trajtimit. (Seksioni A.2)

Sektori i mediave ka një qasje lehtësuese ndaj partive politike dhe sigurimit të hapësirës për to në programet e tyre të lajmeve. Shumë prej mediave vendore kanë mbuluar aktivitetet dhe qëndrimet e përfaqësuesve të ndryshme politikë në programet e tyre, veçanërisht në edicionet e tyre të lajmeve gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në përgjithësi, raportet mbi monitorimin e mediave gjatë kohës së zgjedhjeve tregojnë se mediat kanë mbuluar fushatat e partive politike dhe kandidatëve në pajtim me ligjin. (Seksioni A.3)

3 Qëllimisht, anketa u krye mbi një kuotë kampion prej 50 gazetarësh nga llojet e ndryshme të mediave në Kosovë: 10 gazetarë nga transmetuesi publik, 16 nga stacione private radio dhe TV, 5 nga media private të shkruara, 5 nga agjenci lajmesh, 14 nga media online. Është e rëndësishme të theksohet që edhe pse kuota kampion nuk lejon nxjerrjen e përgjithësimeve në nivel të të gjithë popullsisë së gazetarëve, përgjigjet e marra nga anketa ofrojnë njohuri të vlefshme mbi gjendjen e tashme me liritë e mediave dhe gazetarëve në Kosovë.

4 Mund të gjendet në: <http://www.worldsofjournalism.org/>



Gazetarëve në Kosovë nuk u kërkohet të licencohen nga autoritetet shtetërore për të filluar karrierën e tyre në gazetari. Gjithashtu, nuk ka përpjekje nga autoritetet shtetërore për të imponuar licencimin ose kërkesa të tjera për media të shtypura dhe në Internet. (Seksioni A.4)

Në disa raste, AGK është njoftuar për moslejimin e pjesëmarrjes së gazetarëve në ngjarjet e organizuara nga zyrtarët e qeverisë, për shkak të raportimit të mëparshëm kritik. Gjithashtu, nuk ka kërkesa ndaj gazetarëve në Kosovë që të pajisen me licencë për të punuar si gazetarë. (faqe 22)

Gjithashtu, një tjetër zhvillim i rëndësishëm në legjislationin vendor është miratimi i ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Ligji u mirëprit nga komuniteti i gazetarëve që kërkojnë ta mbrojnë punën e tyre. Janë raportuar raste sporadike kur gazetarët janë kërcënuar nga institucionet shtetërore për të zbuluar burimin e informacionit. (Seksioni A.5, faqe 25).

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen gazetarët është zbatimi i dobët i ligjit për qasje në dokumente publike (Seksioni A.6). Edhe pse qeveria mburret se lejon qasje në dokumente publike, gazetarët e intervistuar dhe të anketuar pohojnë se institucionet shtetërore nuk i zbulojnë dokumentet publike të nevojshme për raportimin e tyre.

#### **Treguesit B: Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës**

Një shqetësim tjetër që është identifikuar në hulumtimin përfshin mungesën e kontratave për gazetarët, të cilët e konsiderojnë atë si trysni të drejtpërdrejtë të ushtruar mbi ta nga pronarët e mediave. Kjo trysni ndikon në pavarësinë dhe paanshmërinë e gazetarëve. (Seksioni B.1)

Përvoja e punës dhe punësimi, deri në një masë, mund ta plotësojnë hendekun në sigurimin e një pasqyre të aspekteve praktike të profesionit. Megjithatë, nuk ka shumë investime për zhvillimin e gazetarëve apo aftësive të tyre të caktuara. Në anketën me gazetarë u tha se pagat e tyre shkojnë nga 200 deri në 500 euro (Seksioni B.1).

Gazetarët gjithashtu ankohen për vonesat e pagave dhe në disa raste vonesa zgjat me muaj. Mungesa e sigurisë financiare është një shqetësim i veçantë, për shkak se gazetarët mund të bëhen të varur nga pronarët, të cilët i keqpërdorin në lidhje me raportimin, qoftë duke zgjedhur perspektivat e raportimit të një lajmi ose duke vendosur të raportohet apo jo.

Mungesa e pronësisë së mediave vazhdon të mbetet problematike, veçanërisht në lidhje me disa media on-

line. Kjo trysni i ka vendosur gazetarët në një pozitë të palakmueshme dhe të paqëndrueshme, e disa prej tyre theksojnë se kur veprojnë në një mjedis të tillë, gazetarët ndërtojnë një vetëdije, madje edhe autocensurë në lidhje me llojin e lajmeve që duhet të sjellin në redaksi që t'u përshtaten pikëpamjeve dhe qëllimit të pronarit (Seksioni B.2).

Transmetuesi publik e ka kodin e vet të sjelljes që konsiderohet shumë i avancuar. Megjithatë, shumica e gazetarëve të intervistuar pohojnë se kodi zbatohet dobët në praktikë nga gazetarët e RTK-së, dhe kjo është për shkak të ndërhyrjes aktive politike, direkt në politikën editoriale. (Seksioni B.3)

Mediat jo-fitimprurëse janë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës për media të shkruar dhe vizive, ndërsa disa kanë kode të brendshme të sjelljes. Sektori jo-fitimprurës i mediave qëndron më mirë në lidhje me financat, duke pasur parasysh se funksionon bazuar vetëm në donacione. Sektori jo-fitimprurës është përlyer me akuzat për financime dhe burime të dyshimta. (Seksioni B.4)

Gazetarët thonë se ndihen që gëzojnë liri më të madhe për të sugjeruar tema, dhe më pak liri për të vendosur se cilat aspekte të një lajmi duhen theksuar, apo perspektivën që lajmi duhet të përfshijë. (Seksioni B.5)

#### **Treguesit C: Siguria e gazetarëve**

Siguria e gazetarëve mbetet një shqetësim, dhe këtu kontribuon mungesa e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Hulumtimi gjeti se nuk ka mekanizma filtrimi në sistemin e drejtësisë për t'u marrë në mënyrë efektive me rastet e gazetarëve të kërcënuar apo të sulmuar, sidomos të femrave gazetare. (Seksioni C.1)

Në lidhje me ndonjë incident të raportuar kundër gazetarëve dhe nga gazetarët, Policia e Kosovës përfundon hetimin dhe rastet ia kalon prokurorisë. Kjo e fundit nuk ishte në gjendje të raportonte sa raste janë ende nën hetime dhe sa aktakuza janë ngritur në tre vitet e fundit. (Seksioni C.1)

Gazetarët kanë gjasa të jenë viktime të preکشme për shkak të një sërë arsyesh, duke përfshirë subjektin e kërcënimeve, pasi ky mund të jetë punëdhënësi i tyre apo një individ ose zyrtar publik për të cilin ata duan të raportojnë. (Seksioni C.1)

Një nga rastet historike që kanë mbetur të pazgjidhura dhe sfidë e madhe për sistemin e drejtësisë, është dështimi i saj për të hetuar siç duhet, identifikuar dhe

ndjekur penalisht autorët vrasjeve të tre gazetarëve pas luftës. Një element veçanërisht shqetësues i këtij rasti është se vrasjet e gazetarëve janë konsideruar të motivuara politikisht. (Seksioni C.1)

Hetimi fillon me policinë, prokurorinë dhe shtrihet deri në gjykata, të cilët duhet të fokusojnë përpjekjet e tyre për të identifikuar ato viktime të pambrojtura, të sigurohen se raportimet e çdo krimi hetohen si duhet dhe çështjet trajtohen me shpejtësi dhe pa vonesa të panevojshme. Siç dihet mirë, drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, edhe pse me interes të mëtejshëm është se fusha në të cilën punojnë gazetarët mund të rezultojë në një situatë që bëhet e paqëndrueshme shumë shpejt, dhe një qasje e pakoordinuar dhe e vonuar mund të rezultojë me pasoja të dëmshme për gazetarët, duke përfshirë edhe humbjen e jetës. (Seksioni C.2)

Ka disa raste që gjykatat vendore kanë dhënë vendime për dënime të pezulluara për autorët e kërcënimeve. Në rastin e tentativës së vrasjes së një gazetari në vendin e tij të punës, gjykatës iu desh një vit për të marrë vendim, i cili rezultoi në ndëshkimin e autorit me katër vjet burg. (Seksioni C.3)

Për më tepër, është raportuar se sundimi i ligjit në Kosovë nuk ndjek të gjithë zinxhirin e aktorëve në sulme, çka jo vetëm nuk sjell drejtësi për viktimat e krimit, por edhe ka një ndikim negativ në perceptimin dhe efektivitetin potencial të zbatimit të ligjit. (Seksioni C.3)

Siguria e gazetarëve mbetet shqetësuese, sidomos për shkak të sjelljes së paparashikueshme të punëdhënësve dhe figurave publike ndaj gazetarëve, qofshin zyrtarë shtetërorë ose pronarë biznesesh, andaj sistemi efektiv i drejtësisë është i domosdoshëm. Teksa situata aktuale është larg nga e dëshirueshme, është e rëndësishme që sistemi i drejtësisë i Kosovës të marra hapat e nevojshëm për të përmirësuar efektivitetin kur trajtohen kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe gazetarëve, dhe të sigurohet që i gjithë zinxhiri i aktorëve në sulme të hetohet tërësisht. (Seksioni C.3)

## Rekomandime

Institucionet publike duhet të marrin në konsideratë në mënyrë aktive mënyra për të përmirësuar zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike, dhe përgjigjet duhet të sigurohen menjëherë.

Institucionet shtetërore të merren efektivisht me rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë edhe marrjen parasysh të krijimit të mekanizmave filtruese dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e gazetarëve.

Pronarët e mediave t'u sigurojnë kontrata pune punonjësve dhe të respektojnë ligjin e punës. Inspektorati i Punës të sigurohet për zbatimin e ligjit të punës, në mënyrë që gazetarët të mos kthehen në viktime të shfrytëzimit.

Inspektorati i Punës të kryejë inspektime të rregullta në media dhe të nxjerrë raporte vjetore mbi gjendjen e mediave në lidhje me të drejtat e punës të punonjësve të mediave.

Policia të trajtojë me përparësi të gjitha rastet kundër gazetarëve, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet, frikësimet dhe shantazhet.

Policia të sigurohet që zyrtarët e saj do të marrin pjesë në trajnime dhe debate mbi marrëdhëniet mes forcave të sigurisë dhe mediave.

Policia të sigurohet se do t'i hetojë plotësisht rastet që përfshijnë rrezikimin e gazetarëve. Policia të sigurohet se do të hetojë të gjithë zinxhirin e sulmit.

Prokuroria t'i trajtojë me përparësi rastet e gazetarëve dhe të ofrojë procese të përshpejtuara për rastet në gjykim.

Prokuroria të sigurohet që zyrtarët e saj do të marrin pjesë në trajnime dhe debate mbi marrëdhëniet mes prokurorisë dhe mediave.

Të forcohet Avokati i Popullit duke ofruar mundësi për rritjen e kapaciteteve dhe të vazhdohet bashkëpunimi me mediat

Gjykatat të trajtojnë me përparësi të gjitha rastet kundër gazetarëve, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet, frikësimet dhe shantazhet.

Gjykatat të kenë procese, të tilla si një bazë të dhënash, ku të regjistrohen dhe arkivohen të gjitha rastet e gazetarëve.

Partitë politike të kufizojnë trysinë në punën e transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës të përqendrohet në Radio Televizionin e Kosovës për të gjetur një mënyrë për financimin afatgjatë dhe për të zgjidhur çështjet e pronës

Kuvendi i Kosovës të sigurojë mbikëqyrje më të madhe të punës së transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës, dhe të miratojë një rol më të madh në promovimin dhe shqyrtimin e zbatimit të lirisë së shprehjes, mediave dhe informacionit

Organet vetërregulluese (KPM dhe KMSHK) të vazhdojnë të angazhohen me mediat dhe publikun, në mënyrë që të zbatojnë mandatin e tyre dhe të kontribuojnë në promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes, mediave dhe informacionit.

**Pasqyrë e treguesve: Për nivelin e  
lirisë së mediave dhe sigurisë së  
gazetarëve në Ballkanin perëndimor**

# A

## Mbrojtja ligjore e lirisë së mediave dhe gazetarëve

### A.1 A ofron legjislacioni vendor garanca për lirinë e mediave dhe a është duke u zbatuar efektivisht në praktikë?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Nëse e drejta e lirisë së shprehjes dhe informimit është e garantuar? A përfshijnë edhe qasjen në internet? A janë zbatuar këto garanci ligjore në praktikë?	Janë të garantuara, duke përfshirë edhe qasjen në internet. Ligji i rendit dhe qetësisë publike në Republika Srpska mban dispozita kufizuese për publikimin e përmbajtjes në internet (rrjete sociale dhe portale).	Është e garantuar, duke përfshirë qasjen në internet. Garancionet ligjore nuk zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.	Është e garantuar, duke përfshirë qasjen në internet. Por, ligjet nuk zbatohen në mënyrë efektive në praktikë.	Është e garantuar, duke përfshirë qasjen në internet. Garancionet ligjore dobët zbatohen në praktikë.	Është e garantuar, duke përfshirë qasjen në internet. Garancionet ligjore nuk zbatohen në praktikë.
Nëse legjislacioni i mediave është zhvilluar në një proces transparent dhe përfshirës?	Në përgjithësi, procesi ka qenë përfshirës dhe transparent. Bashkësia e mediave kishte mundësi të dorëzoj amendamente.	Procesi s'ka qenë mjaftueshëm transparent dhe përfshirës.	Marrëveshje politike për ndryshimet në ligjet e mediave, pa konsultime me bashkësinë e mediave.	Procesi nuk ka qenë as transparent e as përfshirës.	Procesi s'ka qenë mjaftueshëm transparent e përfshirës.
A kanë tentuar autoritetet shtetërore të kufizojnë të drejtën për qasje në internet apo kanë kërkuar të bllokujnë apo filtrojnë përmbajtjen e internetit.	Nuk ka ligj të veçantë për Internetin. Por, Ligji i ri për rendin dhe qetësinë publike të Republika Srpskas mban dispozita që sanksionojnë sjellje "të paduhura" në rrjete sociale.	Draft ligji për media i vitit 2013 ishte një përpjekje për të rregulluar mediat online. Draft ligji i 2015-ës për të bllokuar incizimet e përgjimeve telefonike.	Raste të tilla nuk janë regjistruar ende.	Nuk ka raste të tilla.	Ekzistojnë disa raste ("Feketić", portal i lajmeve Pescanik etj.)

**A.1 A ofron legjislacioni vendor garanca për lirinë e mediave dhe a është duke u zbatuar efektivisht në praktikë?**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A është autoriteti i rregullatorit duke kryer misionin dhe funksionin e saj në një mënyrë të pavarur dhe jo diskriminuese?	Rregullatori nuk është i perceptuar mjaftueshëm si i pavarur dhe efikas në kryerjen e detyrave. Nominimi i anëtarëve të Këshillit të trupit rregullativ është politikisht i motivuar.	Jo, rregullatori është nën ndikim të fortë nga partitë dhe politika. Vendimet e saj janë të njëanshme dhe selektive.	Rregullatori nuk është i perceptuar mjaftueshëm si i pavarur dhe efikas në kryerjen e detyrave.	Rregullatori nuk është i perceptuar si i pavarur. Nominimi i anëtarëve është politikisht i motivuar.	Rregullatori nuk është i perceptuar si mjaftueshëm i pavarur dhe efikas në kryerjen e detyrave.
A ekziston një praktikë e reklamimit nga shteti në media dhe a keqpërdorët për ndikime politike në politikat redaktuese?	Nuk ekzistojnë kriterie transparente dhe të qarta. Alokimi i fondeve është selektiv, politikisht të motivuara dhe jo transparente. Legjislacioni i ri është në proces draftimi.	Reklamata nga shteti në vitet e fundit kanë qenë në masë të madhe të abuzuara për të imponuar ndikim politik tek mediat. Qeveria gjer më qershor 2015 kur moratoriumi për fushatat e qeverisë ishte paralajmëruar, ka qenë njëra ndër reklamuesit më të mëdhenjë tek mediat.	Institucionet publike ndajnë fonde për media në mënyrë selektive dhe jo transparente.	Disa ministri ndajnë financa direkt për disa portale për reklama. Disa janë selektive.	Nuk ka kriterie transparente dhe të qarta. Ndarja e fondeve është selektive dhe jo transparente.
A ekziston ndonjë lloj i subvencioneve për media apo për prodhim të përmbajtjes mediale për interes publik dhe si po zbatohet në praktikë?	Nuk ekzistojnë subvencione për media. Bashkësia e mediave ka dorëzuar dy iniciativa në Ministrinë e Komunikimeve për të themeluar një fond special për prodhimin e përmbajtjes mediale për interes të publikut, por ato nuk janë pranuar.	Ka fonde të alokuara nga buxheti për televizionet kombëtare për prodhime të reja në një mënyrë jo-transparente dhe të njëanshme.	Ekziston një fond për përkrahje të radio transmetuesve komercial, por është kritikuar për favorizim të radiove pro-qeveritare.	Nuk ka subvencione për media.	Skema e fondeve për programet në interes të publikut abuzohet në nivel lokal për ndikime politike.
Cilët janë mekanizmat e financimit të mediave në gjuhët e minoriteteve kombëtare?	Mekanizmat e tillë nuk ekzistojnë.	Nuk ekzistojnë mekanizma për përkrahje financiare të diversitetit të gjuhëve në media edhe pse MRT-ja formalisht ka obligim për të prodhuar përmbajtje në 7 gjuhë të ndryshme.	Ekziston një skemë e fondit për përkrahje të mediave të minoriteteve.	Nuk ekzistojnë mekanizma të tillë të fondeve për mediat private në gjuhët e minoriteteve. Për më shumë, RTK-ja përfshin të gjitha gjuhët e minoriteteve (Serbe, Boshnjake, Turke dhe Rome) në skemën e saj. Minoriteti Serb ka kanal in e saj në RTK që nga qershor 2013.	Ekzistojnë subvencione për media përpërkrahje të mediave në gjuhët e minoritarëve.
A është autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik e garantuar dhe a po mbrohet në mënyrë efikase? A ofron korniza financiare funksionim të pavarur dhe stabil? A përfaqësojnë trupat mbikqyrëse shoqërinë e gjerë?	Autonomia dhe pavarësia janë të garantuara me ligj, por nuk zbatohet në praktikë për shkak të ndikimeve të forta nga partitë politike. Korniza financiare nuk ofron funksionim stabil. Trupat mbikqyrëse nuk përfaqësojnë shoqërinë e gjerë.	Autonomia dhe pavarësia është e garantuar, por nuk zbatohet. Korniza financiare nuk ofron funksionim stabil. Këshilli i MRT-së nuk përfaqëson shoqërinë e gjerë.	Autonomia dhe pavarësia është e garantuar, por mjaftueshëm e zbatuar. Korniza funksionale por nuk ofron funksionim stabil dhe të pavarur. Trupi mbikqyrës nuk përfaqëson shoqërinë e gjerë.	Autonomia dhe pavarësia është e garantuar, por nuk zbatohet. Korniza financiare nuk ofron funksionim stabil dhe të pavarur. Trupi mbikqyrës përfaqëson shoqërinë e gjerë, por është e politizuar.	Autonomia dhe pavarësia është e garantuar. Korniza financiare nuk ofron funksionim stabil. Trupi mbikqyrës nuk përfaqësohet dhe nuk kontrollohet nga shoqëria.

## A.2 A është dekurajues ligji për shpifje në mesin e gazetarëve?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A janë dispozitat e ligjit kundër shpifjes tepër të rënda apo mbrojtëse në përfitim për zyrtarët shtetërorë?	Shpifja është dekriminalizuar. Legjislati aktual është në vijë me ligjet Europiane, por përdorimi i saj në praktikë është kryesisht mbrojtës në dobi të zyrtarëve shtetërorë.	Shpifja është dekriminalizuar në vitin 2012. Ligji mbi përgjegjësinë civile është në vend dhe praktika në gjyq në përgjithësi është e mirë me disa përjashtime negative.	Shpifja është dekriminalizuar. Dispozitat aktuale nuk janë tepër mbrojtëse për zyrtarët shtetërorë.	Shpifja është dekriminalizuar. Dispozitat aktuale nuk janë tepër mbrojtëse për zyrtarët shtetërorë.	Shpifja është dekriminalizuar. Dispozitat aktuale përcaktojnë dënime të mëdha e të papërshtatshme.
Sa padi janë inicuar kundër gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë në tre vitet e fundit?	Numër i madh i padive janë bërë kundër gazetarëve (prej 2003 rreth 100 për vit). Në shtator 2016 ishin 173 raste aktive në gjykata.	Së paku 10 raste të gazetarëve të paditur nga zyrtarët publik / institucione. Më pak raste se sa në vitet e kaluara. Për momentin ekzistojnë 35-40 raste ndaj gazetarëve dhe kjo praktikë në vitin 2012 ishte 10 herë më shumë.	Nuk ka statistika zyrtare.	Janë 20 padi aktuale kundër gazetarëve. Nga këto, gjashtë janë inicuar nga zyrtarët shtetërorë. 9 raste kanë pushuar më 2012 prej se shpifja dhe fyerja u dekriminalizua.	Numër i madh i padive janë bërë kundër gazetarëve (413 në 2014; 406 në 2015).
A ka shembuj kur dispozita tjera ligjore janë përdorur për të "heshtur" gazetaret për kritikë legjitime apo për gazetari hulumtuese?	Rasti i magazinës Slobodna Bosna, e cila u ndal së botuari edicionin e saj të shtypit në dhjetor 2015, nën presionin e numrit të madh të padive për shpifje.	Rasti i gazetarit Kezarovski, i cili ishte paditur për zbulimin e një dëshmitari të "mbrojtur". Rasti tjetër është i gazetarit "Bozinovski" i cili ka aktakuzë për spiunazh dhe zhatje ka qenë në burg në 6 muajt e fundit.	Raste të tilla nuk janë regjistruar.	Nuk ka raste të tilla.	Raste të tilla nuk janë regjistruar deri më tani.
A është drejtësia e administruar në atë mënyrë që është politikisht e motivuar kundër disa gazetarëve? Çfarë dënime janë dhënë?	Gjykatat janë nën ndikim të madh politik. Raste të ngjashme janë interpretuar ndryshe nga gjykatat në entitete të ndryshme. Padi kundër televizionit federal (FTV) janë zgjedhur në favor të kryetarit të republika Srpska. Dënimet nuk janë të larta (përafërsisht 2,500 euro) por disa media kanë nga 20-50 padi.	Gjykatat janë nën ndikim të madh politik. Rasti i gazetës javore kritike "Fokus" – gjykata vendosi dënime të larta për redaktorin dhe gazetarin dhe personi që i ka paditur ishte drejtori i administratës për siguri dhe inteligjencë.	Gjykatat e ulëta administrojnë me rastet mjaft drejtë, gjersa gjykatat e larta janë më shumë rigjide. Dënimet e dhëna nuk janë të larta.	Nuk ka raste të tilla.	Gjykata janë nën ndikim të fortë të politikës. Rasti i TV Forum Prijepolje gazetaret të cilët u kërcënuan nga kryebashkiaku, gjykata e apelit rrëzoi aktgjykimin original dhe liroi kryebashkiakun në procesin 3 ditor.
A i njohin gjykatat mekanizmat vetë-rregullues (nëse ka)? A e pranojnë vlefshmërinë e një përgjigje, korrigjim ose kërkim falje të publikuar?	Gjykata në BeH respektojnë procesin e ndërmjetësimit në mes të ofenduarit dhe medias, që është bërë përmes këshillit të shtypit. Iniciativa është nisur për të ndryshuar ligjin kundër shpifjes në mënyrë që të përfshijë procesin e ndërmjetësimit si të obligueshme para se të bëhet një padi.	Gjykata mund të merr në konsideratë vendimet e Këshillit për Etikë të Mediave sidoqoftë kjo nuk është e obligueshme.	Gjykatat nuk janë të obliguara që të marrin në konsideratë vendimet e trupave vetë rregulluese.	Gjykata nuk i marrin në konsideratë vendimet e trupave vetë rregulluese.	Gjykatat kryesisht nuk i marrin në konsideratë vendimet e trupave vetë rregulluese.

### A.2 A është dekurajues ligji për shpifje në mesin e gazetarëve?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin e shpifjes? A janë të dekurajuar për të hetuar dhe për të shkruar kritika?	79.7% e gazetarëve u përgjigjen se kërcënimi nga shpifja është shumë apo jashtzakonisht ndikues në punën e tyre.	32% e gazetarëve u përgjigjen se kërcënimi nga shpifja është shumë apo jashtzakonisht ndikues në punën e tyre.	44% e gazetarëve u përgjigjen se kërcënimi nga shpifja është shumë apo jashtzakonisht ndikues në punën e tyre.	44% e gazetarëve u përgjigjen se kërcënimi nga shpifja është shumë apo jashtzakonisht ndikues në punën e tyre.	26% e gazetarëve u përgjigjen se kërcënimi nga shpifja është shumë apo jashtzakonisht ndikues në punën e tyre.
Da li sudovi prepoznaju samoregulatorne mehanizme (ukoliko postoje)? Da li prihvataju validnost objavljenog odgovora, demantija ili izvinjenja?	Sudovi u Bosni i Hercegovini poštuju proces medijacije između oštećenog i medijske kuće. Ova inicijativa počela je kao prijedlog za izmjene i dopune zakona o kleveti, koje su se sastojale od uvođenja medijacije kao obaveze prijave podnošenja tužbe.	Sud može odluke Vijeća medijske etike uzeti u obzir ali ove odluke nisu pravno obavezujuće.	Sudovi nisu obavezni da uzimaju odluke samoregulacijskih tijela u obzir.	Sudovi ne uzimaju odluke samoregulacijskih tijela u obzir.	Sudovi većinom ne uzimaju u obzir odluke samoregulacijskih tijela.
Šta novinari misle o zakonu o zaštiti od klevete? Da li su obeshrabljeni da istražuju i pišu kritike?	79,7% je odgovorilo da zakoni o kleveti izuzetno ili veoma utiču na njihov rad.	32 % novinara tvrdi da zakon o kleveti izuzetno ili veoma utiče na njihov rad.	44% novinara tvrdi da zakon o kleveti izuzetno ili veoma utiče na njihov rad.	44% novinara tvrdi da zakon o kleveti izuzetno ili veoma utiče na njihov rad.	26% novinara tvrdi da zakon o kleveti izuzetno ili veoma utiče na njihov rad.

### A.3 A ka mbrojtje ligjore të mjaftueshme të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatës zgjedhore?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A është pluralizmi politik në media i rregulluar në legjislacionin për media (për periudhën jo-zgjedhore)?	Ekziston vetëm një parim themelor për transmetuesit, për të reflektuar pikëpamjet e ndryshme politike dhe burimet e informacionit.	Ekziston vetëm parimi themelor për transmetuesit që të reflektojnë pikëpamjet e ndryshme politike.	Ekziston vetëm parimi themelor për transmetuesit që të reflektojnë pikëpamjet e ndryshme politike.	Ekziston vetëm parimi themelor për transmetuesit që të reflektojnë pikëpamjet e ndryshme politike.	Pluralizmi politik është përcaktuar si një parim themelor për të gjithë transmetuesit.
A është autoriteti i rregullatorit i obliguar që të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik?	Rregullatori është i obliguar të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik vetëm gjatë periudhës zgjedhore.	Rregullatori është i obliguar vetëm në periudhën e fushatës zgjedhore.	Ky obligim nuk është brenda juridiksionit të rregullatorit.	Rregullatori është i obliguar vetëm për periudhën e fushatës zgjedhore.	Rregullatori është i obliguar të mbikqyr transmetuesit dhe të ndërmer masa për periudhën e fushatës zgjedhore.
Cilat janë obligimet ligjore për media gjatë fushatës zgjedhore?	Ligji për Zgjedhje në BeH (Kaptina 16) dhe nën-ligjet e transmetuesit publik. Qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha partitë politike, dhe raportim objektiv, të drejtë e të balancuar.	Kodi zgjedhor dhe nën-ligjet. Qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha partitë politike, dhe raportim objektiv, i drejtë dhe i balancuar.	Kodi zgjedhor dhe ligji për transmetuesin publik. Qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha partitë politike, dhe raportim objektiv, të drejtë e të balancuar.	Ligji për zgjedhje dhe kodi i mirësjelljes së Komisionit të Pavarur për Media. Qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha partitë politike, dhe raportim objektiv, të drejtë e të balancuar.	Ligji për mediat elektronike dhe rregullorja për mbulimin mediatik. Qasje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha partitë politike, dhe raportim objektiv, të drejtë e të balancuar.
A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë periudhës jo-zgjedhore dhe gjatë fushatave zgjedhore?	Partitë politike nuk kanë qasje të drejtë e të barabartë as në periudhën jo-zgjedhore e as në atë zgjedhore.	Partitë politike opozitare nuk kanë qasje të drejtë e të barabartë as në periudhën jo-zgjedhore e as në atë zgjedhore.	Partitë politike nuk kanë qasje të drejtë e të barabartë as në periudhën jo-zgjedhore e as në atë zgjedhore.	Partitë politike në përgjithësi kanë qasje të drejtë e të barabartë gjatë fushatave zgjedhore.	Partitë politike nuk kanë qasje të drejtë e të barabartë as në periudhën jo-zgjedhore e as në atë zgjedhore.

#### A.4 A është e garantuar liria e punës së gazetarëve dhe a po zbatohet në praktikë?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A duhen gazetarët që të liçensohen nga shteti para se ata t'nisin punën?	Gazetarët nuk kanë nevojë për një liçensë nga asnjë autoritet shtetëror. Ishte vetëm një përpjekje për të paraqitur liçensat për gazetarë në vitin 2005, por ishte dënuar dhe nuk është pranuar.	Gazetarët nuk kanë nevojë për liçensë nga ndonjë autoritet shtetëror, por Ligji i Mediave përmban një definicion kufizues të një "gazetari". Ka propozime që vijnë nga gazetarët "pro qeveritar" që paraqesin "liçensa" për gazetarë.	Gazetarët nuk kanë nevojë për një liçensë nga ndonjë autoritet shtetëror. Ka propozime për të paraqitur "liçensa" për gazetarë, me "arsyetimin" e rritjes së profesionalizmit.	Gazetarët nuk kanë nevojë për ndonjë liçensë nga ndonjë autoritet shtetëror.	Gazetarët nuk kanë nevojë për ndonjë liçensë nga ndonjë autoritet shtetëror. Ishte vetëm një përpjekje për të paraqitur liçensat për gazetarë, por ishte dënuar dhe nuk është pranuar.
A kanë qenë gazetarët të refuzuar të raportojnë nga vende dhe ngjarje të caktuara?	Disa raste janë regjistruar: Vendimi i autoriteteve të RS për të ndaluar qasje në ngjarje publike për gazetarët e BeH (2010) dhe FTV (2012); Qasja e refuzuar në Pallatin e presidentit të RS për Liljana Kovacevic, Beta news agency, prej 2012 gjer më sot; dhe për BH TV gjatë 2015. 26% e gazetarëve raportuan se ata ishin të refuzuar të raportojnë nga disa ngjarje sepse ata nuk kishin akreditime.	Një shkelje e madhe ka ndodhur më 24.12.2012, kur shërbimet e sigurimit përjashtuan gazetarët për ti parandaluar ata nga raportimi i rrëzimit të opozitës në Parlament. Po ashtu, gazetarët nuk u lejuan të raportojnë nga disa seanca gjyqësore në gjykatë.	43% e gazetarëve të anketuar raportuan se ata ishin të refuzuar të raportojnë nga disa ngjarje.	Shkelje e fundit ishte rasti i Saranda Ramaj (Koha Ditore). 61% e gazetarëve të anketuar raportuan se ata ishin të refuzuar të raportojnë nga disa ngjarje.	42% e gazetarëve të anketuar raportuan se ata ishin të refuzuar të raportojnë nga disa ngjarje.
A janë dhe si janë gazetarët të organizuar në asociacione profesionale? A ekzistojnë presione në asociacionin e tyre apo anëtarëve individual?	5 asociacione të regjistruara. Asociacioni i Gazetarëve të BeH (BHJA) punon aktivisht. Disa raste të presioneve politike ndaj BHJA dhe sulme verbale janë raportuar ndaj anëtarëve të saj; ueb faqja e BHJA është sulmuar nga hakerët disa herë; Këshilli i shtypit është në mënyrë të përsëritshme nën presion politik dhe presione tjera; më 2014 zyra e saj është thyer dhe dëmtuar; ueb faqja e saj është gjithmonë nën sulme të hakerëve dhe ishte shkatërruar njëherë plotësisht më 3 maj, 2014 (Dita Botërore e Lirisë së Shtypit).	Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë (AJM) është asociacioni më i vjetër (1946) dhe më i madhi, anëtarë e FNG. Ekziston edhe një asociacion (MAN) i aktivizuar më 2013, e cila është e afërt me qeverinë. Anëtarët e AJM-së kanë qenë të nënshtruar disa herë nga presionet deri tash. Përveç kësaj, më 2010 me ndihmë të AJM u themelua SSNM (sindikata e gazetarëve) që merret me çështjet e të drejtave sociale dhe të punës për gazetarë. Më 2013, AJM e ndihmuar për të themeluar Këshillin e Etikës së Mediave që është një palë e interesuar në mbrojtjen e standardeve profesionale.	Janë dy asociacione të gazetarëve, por 80% e gazetarëve nuk janë anëtarë të asnjërit asociacion. Këshilli i Mediave për Vetë-rregullim mbledh një numër të madh të mediave, por jo mediat e mëdha që shihen si kundërshtar të qeverisë. Këto media kanë ombudsmanin e tyre. Nuk ka raste të presioneve ndaj asociacioneve të gazetarëve.	Asociacioni kryesor është Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) që ka më shumë se 400 anëtarë të regjistruar. Nuk ka dëshmi për presione. Ekziston edhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), si trup vetë-rregullues që rregullon mediat e shtypura dhe online.	Dy asociacionet kryesore janë: Asociacioni i Pavarur i Gazetarëve të Serbisë (NUNS) dhe Asociacioni i Gazetarëve të Serbisë (UNS). Është një asociacion regjional dhe asociacion që kryesisht ka gazetarë të punësuar në media me pronë shtetërore dhe Asociacioni i Gazetarëve të Vojvodinës. Ekziston edhe Këshilli i Shtypit, si trup vetë-rregullues. Ekzistojnë shumë presione ndaj asociacioneve të gazetarëve.



#### A.4 A është e garantuar liria e punës së gazetarëve dhe a po zbatohet në praktikë?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A janë dhe si janë të organizuar gazetarët në sindikata? A ka presione ndaj udhëheqësve të sindikatave dhe anëtarëve tjerë?	Ekzistojnë sindikata të punëtorëve në nivele entiteti, në Distriktin e Brçkos dhe te transmetuesit publik. Ekzistojnë së paku 7 sindikata të cilat janë zyrtarisht të regjistruara në BeH. Sindikata e pavarur e transmetuesit publik, sindikata e RTV Goražde dhe sindikata e RTV Una. Disa prej tyre raportojnë për presione politike dhe presione nga menaxhmenti i mediave.	Është Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve të Mediave. Udhëheqësja e saj është shkarkuar nga puna për shkak të aktivitetit në sindikatë.	Udhëheqësi i sindikatës së mediave në Mal të Zi u përjashtua nga puna dhe më vonë u kthye me vendim të gjykatës.	Nuk ka sindikatë që përfaqëson të gjithë gazetarët në vend. Janë dy sindikata brenda RTK-së.	Ekzistojnë dy sindikata: sindikata e gazetarëve të Serbisë dhe Sindikata e Pavarur. Ata janë të dobët dhe në presion kryesisht nga pronarët e mediave. Sindikata e tretë ekziston si pjesë e Sindikata Autonome e Serbisë.
A janë të lirë gazetarët të bëhen anëtarë të sindikatave? Sa gazetarë janë anëtarë të sindikatave?	BHJA raporton për kufizime për gazetarë dhe profesionistët e mediave që të organizojnë një sindikatë. Ekziston një vlerësim se vetëm 16% e mediave kanë arritur që të themelojnë degë të sindikatave. Nuk ka shifra të vlerësuara për anëtarësimin.	Ekziston një sindikatë te transmetuesi publik. Pothuajse asnjë sindikatë në mediat private. Nuk ka shifra të besueshme rreth anëtarësimit, sepse disa anëtarë 'fshehin' vetveten për shkak të frikës nga presioni.	Rreth dy të tretat e gazetarëve nuk janë anëtarë të ndonjë sindikate. Shumica e anëtarëve janë nga transmetuesi publik, gjersa disa janë prej mediave private.	Janë dy sindikata përbrenda transmetuesit publik (RTK). Udhëheqësit e sindikatës kanë qenë nën presion.	Shumica e gazetarëve ndjehen të lirë që të bëhen anëtarë, por ata nuk janë të interesuar sepse sindikatat janë të dobëta. 78% e të anketuarve konfirmuan se ata nuk janë anëtarë.

#### A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Si garantohet fshehtësia e burimeve të gazetarëve në legjislacion?	Është e garantuar në Kushtetutë dhe në disa akte ligjore, edhe pse shumë çështje nuk janë qartësisht të definuara.	Është e garantuar në Kushtetutë dhe në disa akte ligjore.	Është e garantuar në Kushtetutë dhe në disa akte ligjore. Disa dispozita nuk janë mjaftueshëm të qarta.	Është e garantuar me Ligjin e mbrojtjes së burimeve të gazetarëve.	Është e garantuar në Kushtetutë dhe në disa akte ligjore.
A respektohet fshehtësia e burimeve të gazetarëve? A ka shembuj të urdhërave ndaj gazetarëve për të shpalosur burimin e tyre dhe a është arsyetuar ajo për të mbrojtur interesin publik?	Në përgjithësi respektohet, por janë regjistruar disa raste: (1) portali i lajmeve 'Klix' nga Sarajeva, pajisjet e të cilës ishin konfiskuar nga policia më Dhjetor 2014; (2) rasti i Zeljko Rajlic, gazetar nga Banja Luka, të cilin policia e ka kërcënuar me konfiskim të të gjitha pajisjeve.	Në përgjithësi, respektohet, por rasti i Kezarovskit ka treguar se gazetarët mund të burgosen në bazë të dispozitave tjera ligjore.	Janë regjistruar disa raste të presioneve të hapura ndaj gazetarëve për të treguar burimet e tyre.	Disa raste tregojnë se fshehtësia e burimit nuk respektohet (p.sh Indeks-online dhe Blic).	Në përgjithësi, respektohet. Ekzistojnë disa raste sporadike (p.sh. rasti i Teleporter).
A ka pasur sanksione kundër gazetarëve të cilët kanë refuzuar të tregojnë identitetin e burimit?	Nuk ka raste të tilla.	Kezarovski është dënuar me 4,5 vite me burg. Dënimi i tij në fund u zvogëluar në 2,5 vite.	Nuk ka raste të tilla.	Nuk ka raste të tilla.	Raste të tilla nuk janë regjistruar deri më tani.

### A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A ndjehen të lirë gazetarët kur kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?	49 % e gazetarëve të anketuar theksuan se ata rregullisht apo shumë shpesh mbajnë kontakte me burimet e tyre.	36% e gazetarëve të anketuar theksuan se ata rregullisht apo shumë shpesh mbajnë kontakte me burimet e tyre.	67% e gazetarëve të anketuar theksuan se ata rregullisht apo shumë shpesh mbajnë kontakte me burimet e tyre.	50% e gazetarëve të anketuar theksuan se ata rregullisht apo shumë shpesh mbajnë kontakte me burimet e tyre.	64% e gazetarëve të anketuar theksuan se ata rregullisht apo shumë shpesh mbajnë kontakte me burimet e tyre.

### A.6 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore në të drejtën për qasje në informacion?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Cilat janë rregullat ligjore për qasje në dokumente zyrtare dhe informacione të cilat janë relevante për gazetarët?	Qasja është e garantuar. Nuk ka dispozita specifike relevante për gazetarët. Gjykata e BeH dhe institucionet tjera gjyqësore kanë procedura speciale për të marrë informacione nga ata dhe raportimi nga ky institucion.	Qasja është e garantuar. Nuk ka dispozita specifike relevante për gazetarët. Zbatimi është i dobët.	Qasja është e garantuar. Nuk ka dispozita specifike relevante për gazetarët.	Qasja është e garantuar. Nuk ka dispozita specifike relevante për gazetarët. Zbatimi është i dobët.	Qasja është e garantuar. Ekziston Komisioneri për të drejtën në qasje të informacioneve dhe në mbrojtjen e të dhënave personale si një trup shtetëror i pavarur.
A i përdorin këto rregulla gazetarët? A i përfillin rregullat autoritetet pa vonesa? Sa refuzime janë raportuar nga gazetarët?	Gazetarët në BeH i përdorin dispozitat ligjore, por ankohen se procedurat janë shumë të gjata dhe afatet kohore nuk janë të përshatshme për ata. 27% e gazetarëve të anketuar që kanë dorëzuar kërkesa ishin refuzuar.	Gazetarët nuk janë mirë të informuar për rregullat dhe rrallë i përdorin. Këta që kanë kërkuar qasje janë refuzuar shpesh.	Gazetarët rrallë përdorin këto dispozita. 37% e gazetarëve të anketuar që kanë dorëzuar kërkesa për qasje janë refuzuar.	78% e gazetarëve të anketuar theksuan se institucionet kanë refuzuar t'u japin atyre dokumentet e kërkuara.	Gazetarët në Serbi e përdorin të drejtën për qasje. 42% e gazetarëve theksuan se ata kanë dorëzuar kërkesa por janë refuzuar nga institucionet.
A janë gjykatat transparente? A ofrohet qasja e mediave në procedimet ligjore në baza jo-diskriminuese dhe pa kufizime të panevojshme?	74,4% e gazetarëve theksuan se gjykatat demonstronin diq (19,3%), goxha (26,1%) apo transparencë të plotë (29%).	48% e gazetarëve theksuan se gjykatat tregojnë pak (24%) apo aspak transparencë (24%), gjersa 25% mendojnë se ata demonstronin deri diku nivelin e transparencës.	44,5% e gazetarëve theksuan se gjykatat tregojnë deri diku (29,6%), goxha (9,3%) apo transparencë të plotë (5,6%).	48,1% e gazetarëve theksuan se gjykatat paraqesin deri diku nivel të transparencës. 37% mendojnë se gjykatat janë pak transparente dhe 7,4% mendojnë se nuk janë transparent fare.	59,4% e gazetarëve theksuan se gjykatat janë pak (37,8%) apo aspak transparente (21,6%), gjersa 24,3% mendojnë se ato tregojnë deri diku nivelin e transparencës.
A ofrohen qasje publike në seancat e parlamentit? A ka kufizime për gazetarë për të prërcjellur punën e parlamentit?	77,8% e gazetarëve theksuan se Parlamenti demonstroi disi (10%), goxha (73%), apo transparencë të plotë (29%).	31% e gazetarëve theksuan se Parlamenti paraqet pak (25%) apo aspak transparencë (6%), gjersa 31% mendojnë se paraqet deri diku nivel të transparencës.	72,2% e gazetarëve theksuan se Parlamenti paraqet deri diku transparencë (25,9%), goxha (31,5%) apo transparencë të plotë (14,8%).	44,4% e gazetarëve theksuan se Parlamenti paraqet deri diku nivel të transparencës. 22,2% mendojnë se Parlamenti është goxha transparent dhe 7,4% mendojnë se tregojnë transparencë të plotë.	64,8% e gazetarëve theksuan se parlamenti demonstroi deri diku (7,2%), goxha (14,4%), dhe transparencë të plotë (43,2%).
Sa është e hapur qeveria dhe ministritë përkatëse?	61% e gazetarëve theksuan se Qeveria tregon pak (29%) apo aspak transparencë (32%).	46% e gazetarëve theksuan se Qeveria paraqet pak transparencë (25%) apo aspak transparencë (21%), gjersa 21% mendojnë se tregon deri diku transparencë.	50% e gazetarëve theksuan se Qeveria tregon deri diku nivel të transparencës, gjersa vetëm 16,7% mendojnë se tregon pak apo aspak transparencë.	48% e gazetarëve theksuan se Qeveria paraqet pak (37%) apo aspak transparencë (11%), gjersa 40% theksuan se është deri diku transparente.	59,4% e gazetarëve theksuan se Qeveria tregon pak (37,7%) apo aspak transparencë (21,7%). 24,3% mendojnë se është deri diku transparente.

# B

## Pozita e gazetarëve nëpër redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

### B.1 A keqpërdoret pozita ekonomike e gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë mbrojtje adekuata sociale? Sa janë pagat e larta të gazetarëve? A paguhen ata rregullisht?	Ka vlerësime se ndërmjet 35%- 40% e gazetarëve nuk kanë as kontrata pune e as siguim social dhe shëndetsor. Ata me kontrata valide nuk janë mjaftueshëm të mbrojtur. Situata është më e keqe në mediat private. Pagat në mediat lokale sillen prej 200 deri në 500, te transmetuesi public paga mesatare është 700 euro, gjersa në disa media private (duke përfshirë mediat ndërkombëtare) rreth 900 euro.	Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e gazetarëve të punësuar me kontrata pune të nënshkruara. Disa studime tregojnë se rreth gjysma e gazetarëve kanë kontrata pune me përfitime sociale e të punësimit. 58% e gazetarëve të anketuar fitojnë deri në 360 euro.	Rreth 800 gazetarë janë të punësuar, gjysma e tyre në transmetuesin public. Nuk ka shifra të sakta për numrin e tyre me kontrata pune të nënshkruara. Paga mesatare e gazetarit është 470 euro. Rreth gjysma e gazetarëve paguhen rregullisht.	Nuk ka të dhëna të sakta, por është e njohur se shumë gazetarë nuk kanë kontrata pune. Gjysma e gazetarëve në anket theksuan se pagat e tyre sillen prej 200 deri në 500 euro. Vonesat shkojnë deri në disa muaj. Pagat nuk paguhen të plota.	Nuk ka të dhëna të sakta për numrin e gazetarëve të punësuar me kontrata pune të nënshkruara. Shumë shpesh të drejtat e punës te gazetarët nuk respektohen. Paga mesatare e gazetarit është 400 euro. Pagat nuk paguhen me rregull.

**B.1 A keqërdoret pozita ekonomike e gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Çfarë janë kushtet e punës për gazetarë? Cilat janë problemet më të mëdha që ta ballafaqohen në vendin e tyre të punës? A e shohin pozitën e tyre për të mirë apo për të keq krahasuar me periudhat e mëhershme?	Puna e pasigurt. Punëdhënësit mund të ndërprejnë kontratat në çdo kohë dhe gazetarët nuk kanë asnjë mbrojtje ligjore. Shumica e gazetarëve tha se pozita e tyre ekonomike dhe sociale është më keq se 2-3 vjet më parë. Në anketë, 74% e gazetarëve ka deklaruar se pozita e tyre ekonomike është ulur shumë.	Puna e pasigurt. 77% e gazetarëve të anketuar më 2014 konsideruan si të pasigurtë angazhimin e tyre actual. 80% konsideruan se pozita ekonomike e tyre është përkeqësuar.	Puna e pasigurt. Shumë gazetarë në mediat private punojnë jashtë orarit, dhe mbulojnë shumë fusha të ndryshme. 54% e gazetarëve të anketuar konsiderojnë pozitën e tyre ekonomike duke u përkeqësuar.	Puna e pasigurt. Gazetarët punojnë jashtë orarit apo gjatë festave pa kompensime. Gjysma e gazetarëve të anketuar thanë se pozita e tyre ekonomike është përkeqësuar.	Puna e pasigurt. Gazetarët janë të detyruar të punojnë edhe në detyra tjera dhe të angazhohen në marketing. 76% e gazetarëve thanë se pozita e tyre ekonomike është përkeqësuar shumë duke krahasuar me vitet e kaluara.

**B.2 Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale nga pronarët e mediave dhe trupave menaxhuese?**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Sa media kanë struktura të brendshme organizative që mbajnë redaksitë të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamenti i marketingut?	Redaksitë në media private nuk janë të ndara dhe të pavarura.	Vetëm mediat e mëdha mbajnë redaksitë të ndara, por ato janë të ndikuara nga interesat ekonomike dhe politike.	Shumica e mediave private nuk kanë struktura të brendshme dhe redaksitë nuk janë të ndara ng menaxherët dhe marketing.	Mediat më të mëdha mbajnë redaksitë të ndara, por ato prapë janë të ndikuara nga menaxherët dhe pronarët.	Shumica e mediave private nuk kanë strukturë të brendshme dhe redaksitë nuk janë të ndara nga menaxherët dhe marketing. Shumë prej tyre nuk kanë madje as akte ligjore.
A kanë vendosur rregulla mediat private për pavarësinë editoriale nga pronarët e mediave dhe trupave menaxhuese? A respektohen këto rregulla?	Rregulla redaktuese të brendshme ekzistojnë në disa media por ato nuk janë efikase. Nuk ka dispozita që garantojnë pavarësinë e gazetarëve dhe të drejtën e tyre për të refuzuar punët që nuk janë në pajtim me standardet profesionale dhe etike.	Shumë pak media kanë rregulla të tilla. Edhe aty ku ekzistojnë në përgjithësi ato nuk respektohen.	Shumë pak media kanë rregulla të tilla. Edhe aty ku ekzistojnë në përgjithësi ato nuk respektohen.	Shumë pak media kanë rregulla të tilla.	Mbetet e panjohur nëse ndonjë nga mediat private kanë adoptuar rregulla të brendshme për politikat redaktuese.
A i kanë adoptuar redaksitë e mediave private kodet e brendshme të etikës apo i përfillin kodit të përgjithshëm të etikës?	Shumica e mediave private nuk kanë kod të brendshëm por mbështeten në kodin e përgjithshëm etik.	Mediat private nuk kanë kod etik të brendshëm. Ata mbështeten në kodin e përgjithshëm etik.	Mediat private nuk kanë kod etik të brendshëm. Ata mbështeten në kodin e përgjithshëm etik.	Shumica e mediave private mbështeten në Kodin e Etikës nga Këshilli i Mediave të Shkruara.	Shumica e mediave private nuk kanë kod të brendshëm por mbështeten në kodin e përgjithshëm të etikës të asociacioneve të gazetarëve.

## B.2 Cili është niveli i pavarësisë redaktoriale nga pronarët e mediave dhe trupave menaxhuese?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Cilat janë format më të zakonshme të presionit që pronarët e mediave dhe menaxherët ushtrojnë mbi redaksitë apo tek gazetaret individual?	Pronarët apo drejtorët e programeve filtrojnë në vendime nëse duhet të publikohet një informacion i caktuar apo jo. Format direkte të presionit: paga shumë të ulëta, kërcënime për humbje të punës, frikësimi, punë të shpeshtë jashtë orarit, 'artikuj të porositur' etj.	Format direkte të presionit: kërcënime për humbje të punës, kërcënime fizike, kërcënime për humbje të punës të afërmit në administratë publike.	Pronarët nuk pranojnë raportime kritike kundrejt biznesmenëve të fuqishëm. Ka auto-censurë ndërmjet gazetarëve.	Mungesa e kontratave të punës që qojnë në auto-censurë. Pagat e vonuara janë po ashtu edhe një presion direkt kundër gazetarëve.	Gazetarët mbahen në mënyrë të vazhdueshme nën frikë nga përjashtimi nga puna. Frikësimi është shumë i shpeshtë. Pronarët kërkojnë nga gazetaret që të punojnë në disa tema duke i larguar nga disa të tjera.

## B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në transmetuesin publik?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A e ka adoptuar transmetuesi publik kodin e mirësjelljes së gazetarëve dhe të pavarësisë editoriale? A e përfillin gazetaret këtë kod?	Të gjithë transmetuesit publik kanë adoptuar Parimet Editoriale, por ato pothuajse nuk respektohen në praktikë. Gazetarët në transmetuesin publik punojnë nën presion dhe puna e tyre është e ndikuar në baza ditore.	Kodi i Përgjithshëm i mirësjelljes nuk është adoptuar, megjithatë kjo është një obligim i transmetuesit publik në statutin e tij. Kodi i etikës për periuhë të zgjedhjeve është adoptuar më 2016 me përkrahje të ekspertëve Britanez dhe palëve vendore.	Transmetuesi publik ka kodin e etikës, por për të gjithë punëtorët. Gazetarët nuk përmenden. Nuk ka kod të mirësjelljes për gazetarë. Pavarësia editoriale e transmetuesit publik është një shqetësim.	Transmetuesi publik ka kodin e tij të mirësjelljes. Kodi zbatohet dobët në praktikë.	Radio Televizioni i Serbisë dhe Radio Televizioni i Vojvodinës nuk e kanë kodin e tyre specifik të parimeve etike për raportim, por kanë vetëm kodin e përgjithshëm për të gjithë punëtorët.
A i kanë transmetuesit publik të krijuara rregulla të brendshme organizative që të mbajnë redaksitë të pavarura nga trupat menaxhues? A respektohen këto rregulla?	Transmetuesit publik i kanë adoptuar rregullat e brendshme organizative por redaksitë nuk janë të pavarura nga trupat menaxhues e qeverisë.	Transmetuesi publik ka organizim të brendshëm por redaksitë nuk janë të pavarura nga trupat menaxhues.	Transmetuesi publik ka organizim të brendshëm por redaksitë nuk janë të pavarura nga trupat menaxhues.	Transmetuesi publik ka organizim të brendshëm por redaksitë nuk janë të pavarura nga trupat menaxhues.	Të dy transmetuesit publik kanë rregulla që të mbajnë redaksitë të ndara dhe të pavarura nga menaxhmenti, por ato nuk respektohen në praktikë.
Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron në redaksi apo te gazetaret individual në transmetuesin publik?	Ekzistojnë forma indirekte të presioneve përmes menaxhmentit dhe Komitetit Drejtues. Por gjithashtu ka presione direkte madje edhe nga anëtarët e presidencës së BeH, parlamentit të BeH, presidenti i Republika Srpskas, kryeministri nga të dyja entitetet dhe ministrinë.	Zyrtarët qeveritarë ndikojnë përmes menaxhmentit të transmetuesit publik (Këshilli i Programit në MRT).	Zyrtarët qeveritarë ndikojnë përmes menaxhmentit të transmetuesit publik. Së fundmi është bërë një ndërrim i redaktorëve udhëheqës në shërbimin publik, dhe situata është përmirësuar pjesërisht.	Zyrtarët qeveritarë ndikojnë përmes menaxhmentit të transmetuesit publik.	Ekzistojnë forma indirekte të presionit (përmes menaxhmentit), por po ashtu presione direkte (madje edhe nga Kryeministri).

**B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në transmetuesin publik?**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Cili ka qenë shembulli më ilustrativ i presionit të ushtruar nga qeveria në punën e tërë redaksisë apo gazetari individual?	Më qershor 2016 parlamenti i BeH nuk ka marrë vendim për kornizën financuese për të tre transmetuesit publik në BeH. Presidenti i RS-së, Milorad Dodik ka sulmuar verbalisht korrespondentit e FTV nga Banja Luka.	Inçizime të publikuara nga skandali i përgjimeve zbuloi se zyrtërit e qeverisë kanë kërcënuar gazetaret e transmetuesit publik me vend të punës nëse ata nuk raportojnë sipas vijës 'dëshiruese'.	Rasti i gazetarit Mirko Boskovic i cili nuk pranonte detyra të punës pasi që publikoi një seri të lajmeve televizive më 2015, për krimin dhe korrupsionin, që ka përfshirë njërin nga kryebashkiakët e komunave.	Në prill 2015, 60 gazetarë dhe redaktorë shkruan një letër publike duke kritikuar menaxhmentin dhe drejtorin gjeneral për ndërhyrje, censurë dhe keqmenaxhim.	Më 2015 Partia Progresiste Serbe ka sulmuar publikisht transmetuesin publik të Serbisë për transmetim të një intervistë me redaktorin e së përditshmes Danas në të cilën u kritikua Kryeministri.

**B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A e ka adoptuar mediat jo-fitimprurëse kodin e mirësjelljes së gazetarëve dhe të pavarësisë editoriale? A e përfillin gazetaret këtë kod?	Ekzistojnë tri radio stacione jo-fitimprurëse në BeH. Janë po ashtu edhe disa media online të lajmeve të cilat janë të përkrahura nga donatorët ndërkombëtarë. Të gjitha këto përdorin kodin ekzistues të praktikës dhe Kodin e Shtypit të adoptuar në BeH.	Ekzistojnë vetëm tri radio stacione jo-fitimprurëse që kanë cak studentët. Janë disa portale që janë themeluar si media jo-fitimprurëse. Gazetarët profesionistë janë të punësuar vetëm në portalet e lajmeve. Ata përfillin kodin e përgjithshëm të etikës.	Mediat jo-fitimprurëse nuk janë të zhvilluara. Ekziston një radio e bashkësisë. Asnjë gazetar profesional i punësuar.	Shumë pak media jo-profitabile ekzistojnë në Kosovë. Ata përfillin kodin e përgjithshëm të etikës të Komisionit të Pavarur të Mediave (për transmetuesit) dhe të Këshillit të Mediave të Shkruara (për mediat e shtypura dhe online).	Shumë pak media jo-profitabile ekzistojnë në Serbi. Ata mbështeten në kodin e përgjithshëm të etikës të asociacioneve të gazetarëve.
Cilat janë format më të zakonshme të presionit ndaj mediave jo-fitimprurëse?	Ndonjëherë referohen si "mercenarë të huaj" sepse ata financohen nga donacionet. Mediat tjera refuzojnë të publikojnë artikujt e tyre hulumtuese.	Ekzistojnë forma të presioneve ndaj gazetarëve në portalet e lajmeve që janë kritikuese kundrejt Qeverisë.	Nuk ka raste të tilla.	Ata ndonjëherë referohen si "mercenarë të huaj" sepse ata pranojnë fonde nga donatorët e huaj.	Ata shpesh sulmohen publikisht nga mediat pro-qeveritare si "mercenarë të huaj" sepse ata pranojnë fonde nga donatorët e huaj.
Cili ka qenë shembulli më ilustrativ i presionit të ushtruar në mediat jo-fitimprurës?	Sulme brutale verbale, gjuhë të urrejtjes, ngacmime dhe diskriminim ndaj gazetareve femra të Qendrës për Raportim Hulumtues (CIN). Refuzimi i informacionit, kërcënime verbale po ashtu edhe kërcënime për gazetaret e portalit 'Zurnal' për publikimin e të dhënave të pronave të disa politikanëve (2014 dhe Korrik 2016).	Nuk ka raste të tilla.	Nuk ka raste të tilla.	Rasti i Rrjetit Ballkanik për Raportim Hulumtues (BIRN) e cila është sulmuar nga një fushatë njollosëse nga e përditshmja "Infopress".	Rasti i Rrjetit për Hulumtim të Krimin dhe Korrupsionit (KRIK), e cila është sulmuar tabloidi <i>Informër</i> .

### B.5 Sa kanë liri gazetarët në procesin e prodhimit të lajmit?

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Sa kanë liri gazetarët që të përzgjedhin lajme që ata punojnë dhe sa kanë liri për të vendosur se cili kënd i lajmit duhet të theksohet?	54 % e gazetarëve të anketuar theksuan se ata kanë liri të majftueshme (29%) apo të plotë (25%) për të zgjedhur lajmet. 59% thanë se ata janë të lirë të vendosin se cilat aspekte të lajmit duhet të theksohen.	57% e gazetarëve të anketuar raportuan se kanë shumë liri (36%) apo liri të plotë (21%) për të zgjedhur lajmet. Madje më shumë gazetarë (71%) thanë se ata janë të lirë të vendosin se cilin aspekt të një lajmi duhet të nënvizohet.	57% e gazetarëve të anketuar thanë se kanë liri të shumë liri (35%) apo liri të plotë (22%) për të zgjedhur lajme. 61,5% e gazetarëve thanë se ata kanë shumë liri (31,5%) apo liri të plotë (30%) për të vendosur se cilin kënd të lajmit duhet theksuar.	62% e gazetarëve të anketuar thanë se ata kanë shumë liri (28%) apo liri të plotë (32%) në përzgjedhjen e lajmit. 52% theksuan se janë të lirë të vendosin se cilin aspekt të lajmit duhet theksuar.	58% e gazetarëve të anketuar thanë se kanë shumë liri (30%) apo liri të plotë (28%) për të përzgjedhur lajme. 62% theksuan se ata janë të lirë të vendosin se cilin aspekt të lajmit duhet theksuar.
Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në kordinimin redaktues dhe të redaksisë (pjesëmarrje në takimet e redaksisë apo përcaktimin e gazetarëve)?	64% e gazetarëve të anketuar marrin pjesë gjithmonë apo shumë shpesh në mbledhjet e redaksisë.	48% e gazetarëve të anketuar marrin pjesë gjithmonë apo shumë shpesh në mbledhjet e redaksisë.	73% e gazetarëve të anketuar marrin pjesë gjithmonë apo shumë shpesh në mbledhjet e redaksisë.	86% e gazetarëve të anketuar marrin pjesë gjithmonë apo shumë shpesh në mbledhjet e redaksisë.	62% e gazetarëve të anketuar marrin pjesë gjithmonë apo shumë shpesh në mbledhjet e redaksisë.
Cilat janë vetë-perceptimet e gazetarëve në shkallën në të cilën ata kanë qenë të ndikuar nga burime të ndryshme të ndikimit: redaktorëve, menaxherët, pronarët, aktorët politik, shteti?	Redaktorët janë më ndikuesit të puna e gazetarëve (77%), pastaj pronarët (45%), memaxherët (39%), dhe zyrtarët qeveritarë (24%).	Redaktorët janë më ndikuesit të puna e gazetarëve (53%), pastaj zyrtarët qeveritarë (46%), menaxherët (40%) dhe pronarët (39%).	Redaktorët janë më ndikuesit të puna e gazetarëve (83%), pastaj menaxherët (63%), pronarët (56%) dhe zyrtarët qeveritarë (28%).	Redaktorët janë më ndikuesit të puna e gazetarëve (50%), pastaj menaxherët (30%), grupet e presionit (16%), qeveria (10%) dhe politikanët (8%).	Redaktorët janë më ndikuesit të puna e gazetarëve (76%), pastaj menaxherët (49%), pronarët (42%) dhe zyrtarët qeveritarë (26%).
Sa gazetarë kanë raportuar censurën? Sa gazetarët raportojnë se janë të nënshtruar ndaj vetë-censurës për shkak të frikës ose të humbjes së punës së tyre ose nga rreziqe të tjera?	51% e gazetarëve të anketuar theksuan se censura ka ndikuar në punën e tyre.	55% e gazetarëve të anketuar theksuan se censura ka ndikuar në punën e tyre.	55% e gazetarëve të anketuar theksuan se censura ka ndikuar në punën e tyre.	30% e gazetarëve të anketuar theksuan se censura ka deri diku ndikim në punën e tyre.	Auto censura është problemi më i madh, megjithatë 41% e gazetarëve të anketuar theksuan se censura ka ndikim në punën e tyre.

## C.1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkueshmërisë (3 vite prapa dhe për vrasjet 15-20 vite prapa)

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Numri dhe llojet e kërcënimeve kundër jetës së gazetarit dhe llojet tjera të kërcënimeve.	Nga 2013 gjer më shtator 2016: 65 kërcënime verbale dhe presione; 21 sulme fizike; 7 kërcënime me vdekje; 15 frikësime/diskriminime; 35 raste tjera.	Bazuar në regjistrin e Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë nga 02.06.2011 gjer tash, janë 35 raste të dhunës ndaj gazetarëve (kërcënime me vdekje, dhunë fizike, shkatërrim i pronës private, burgim etj.)	Nga 2013 gjer më qershor 2016 janë 8 kërcënime verbale.	Nga 2013 gjer më gusht 2016, Policia e Kosovës ka regjistruar 63 raste të raportuara nga gazetarët e Kosovës.	Nga 2013 gjer më qershor 2016 janë: 69 kërcënime verbale dhe 32 presione.
Numri i sulmeve aktual. Sa gazetarë janë <i>sulmuar</i> ?	Nga Janari gjer më shtator 2016 së paku 7 sulme fizike.	Në total janë 35 raste të regjistruara.	Prej 2013 gjer më qershor 2016: 1 sulm fizik dhe 7 sulme në pronë.	Prej 2013 gjer më gusht 2016 janë 12 sulme fizike dhe 13 sulme në pronë.	Prej 2013 gjer më qershor 2016 janë 33 sulme fizike dhe 9 sulme në pronë.
Numri dhe lloji i vrasjes. Sa gazetarë janë vrarë në 15-20 vitet e fundit?	Prej 1992 gjer më 1995 – 38 gazetarë dhe profesionistë të medias janë vrarë (38 qytetarë të BeH and 7 të huaj). Pas luftës në BeH, tentim vrasje ka pasur Zeljko Kopanja, pronar i të përditshmës Gazeta e Pavarur nga Banja Luka.	Zyrtarisht nuk ka raste të tilla viteve të fundit.	Një vrasje më 2004.	Tri vrasje: 2000, 2001 dhe 2005.	Tri vrasje: 1994, 1999 dhe 2001.



### C.1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkueshmërisë (3 vite prapa dhe për vrasjet 15-20 vite prapa)

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Numri dhe llojet e kërcënimeve kundër jetës së gazetarit dhe llojet tjera të kërcënimeve.	Nga 2013 gjer më shtator 2016: 65 kërcënime verbale dhe presione; 21 sulme fizike; 7 kërcënime me vdekje; 15 frikësime/diskriminime; 35 raste tjera.	Bazuar në regjistrin e Asociacionit të Gazetarëve të Maqedonisë nga 02.06.2011 gjer tash, janë 35 raste të dhunës ndaj gazetarëve (kërcënime me vdekje, dhunë fizike, shkatërrim i pronës private, burgim etj.)	Nga 2013 gjer më qershor 2016 janë 8 kërcënime verbale.	Nga 2013 gjer më gusht 2016, Policia e Kosovës ka regjistruar 63 raste të raportuara nga gazetarët e Kosovës.	Nga 2013 gjer më qershor 2016 janë: 69 kërcënime verbale dhe 32 presione.
Numri i sulmeve aktual. Sa gazetarë janë sulmuar?	Nga Janari gjer më shtator 2016 së paku 7 sulme fizike.	Në total janë 35 raste të regjistruara.	Prej 2013 gjer më qershor 2016: 1 sulm fizik dhe 7 sulme në pronë.	Prej 2013 gjer më gusht 2016 janë 12 sulme fizike dhe 13 sulme në pronë.	Prej 2013 gjer më qershor 2016 janë 9 sulme fizike dhe 9 sulme në pronë.
Numri dhe lloji i vrasjes. Sa gazetarë janë vrarë në 15-20 vitet e fundit?	Prej 1992 gjer më 1995 – 38 gazetarë dhe profesionistë të medias janë vrarë (38 qytetarë të BeH and 7 të huaj). Pas luftës në BeH, tentim vrasje ka pasur Zeljko Kopanja, pronar i të përditshmës Gazeta e Pavarur nga Banja Luka.	Zyrtarisht nuk ka raste të tilla viteve të fundit.	Një vrasje më 2004.	Tri vrasje: 2000, 2001 dhe 2005.	Tri vrasje: 1994, 1999 dhe 2001.
Numri dhe lloji i kërcënimeve dhe sulmeve në institucione mediale, organizata, media dhe asociacione të gazetarëve.	Prej 2013 janë 217 sulme në media, institucione mediale, sindikata, asociacione të gazetarëve dhe Këshillit të Shtypit (Press Council) të Bosnje dhe Hercegovinës (BeH).	Asociacioni i Gazetarëve, Këshilli i Etikës së Mediave dhe organizata tjera që janë kritike kundrejt qeverisë janë shpesh subject i sulmeve. Kjo është shënuar edhe në raportin e KE-së.	Prej 2013 janë 4 sulme në media. Nuk ka të dhëna për sulme ndaj organizatave tjera.	Tri sulme me armë. Në 2015, portali KOSSEV në Mitrovicë sulmohet me armë zjarri. Më 2016, RTK sulmet dy herë me granatë dore.	Prej 2014 janë 275 sulme në portale të lajmeve dhe presione tjera ndaj gazetarëve dhe redaktorëve të tyre. Nuk ka të dhëna rreth sulmeve në organizatat tjera.

### C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve? (3 vite prapa)

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A kanë zhvilluar institucionet shtetërore politika specifike që përkrahin mbrojtjen e gazetarëve online dhe ata të shtypit? Nëse po, a është zbatimi i këtyre politikave i siguruar me burime dhe ekspertizë të mjaftueshme?	Ministria e të Drejtave të Njeriut ka adoptuar Planin e Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, njëri kapitull është i fokusuar në mbrojtjen e lirisë së mediave dhe të drejtave të gazetarit, posaçërisht në rastet e sulmeve dhe presioneve. Ministria e Drejtësisë ka draftuar ndryshimet për Ligjin Penal për të mbrojtur gazetarët që janë viktimë të sulmit.	Në Maqedoni është një trend i mosndëshkueshmërisë kur janë në pyetje të drejtat e gazetarëve. Institucionet shtetërore nuk kanë zhvilluar ndonjë politikë apo masa për mbrojtjen e gazetarëve.	Nuk ka politika të zhvilluara.	Nuk ka politika të zhvilluara.	Nuk ka politika të zhvilluara. Kishte përpjekje: draft-Memorandum ndërmjet asociacioneve të gazetarëve dhe institucioneve relevante.

## C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve? (3 vite prapa)

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A ka mekanizma (institucione, programe dhe bugjet) për monitorim dhe raportim për kërcënime, ngacmime dhe dhunë kundër gazetarëve? Kush i monitoron dhe mban të dhëna për sulmet dhe kërcënimet? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna të azhuruara rreth sulmeve ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmërisë? Cilat masa janë marrë pas incidentit dhe nga kush?	Nuk ka mekanizma të tillë. Free Media Help Line është një shërbim unik për të ofruar ndihmë pa pagesë ligjore dhe profesionale. FMHL-ja ndan të dhënat e saja dhe shqyrtimet e rasteve me të gjitha institucionet, media, organizata mediale dhe organizata ndërkombëtare.	Nuk ka mekanizma të tillë. Asnjë masë disiplinore nuk është marrë kundër asnjërit nga autorët e krimit. Ndodh jashtëzakonisht rrallë kur politikanët dënojnë rastet e sulmeve kundër gazetarëve.	Nuk ka mekanizma të tillë. Prokurori Publik i Shtetit dhe administrata e policisë monitorojnë dhe mbajnë të dhëna. Deri më tani, të dhënat për numrin e sulmeve dhe të masave janë publikuar.	Nuk ka mekanizma të tillë. Viteve të fundit, Policia e Kosovës ka filluar të përgatis një list me kërcënime dhe sulme kundër gazetarëve. Asnjë institucion shtetëror nuk publikon të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve.	Nuk ka mekanizma të zhvilluar, por përpjekje të caktuara janë bërë. Në dhjetor 2015 janë adoptuar udhëzimet mbi evidencat e krimeve kundër gazetarëve dhe sulmet në sajte të internetit. Ato janë zbatuar menjëherë. Të gjitha zyret e prokurorisë publike dorëzojnë evidencën tremujore tek Prokurori Publik i Shtetit i cili monitoron dhe zbaton dhe mban të dhënat. Si pjesë e aktiviteteve të saj të rregullta, APGS regjistron të gjitha incidentet e raportuara dhe përcjell.
A njihen sulmet në sigurinë e gazetarëve nga institucionet qeverisëse si shkelje të lirisë së shprehjes, ligjit të drejtave të njeriut dhe ligjit penal? A i bëjnë zyrtarët publik deklaratat e tyre të qarta se i njohin sigurinë e gazetarëve dhe a i dënojnë sulmet mbi ta?	Jo deri më tash. Ministrinë e BeH-së janë duke punuar në ndryshimet e Ligjit Penal dhe në zhvillimin procedurave të brendshme për mbrojtjen e gazetarëve dhe lirinë e shprehjes si një e drejtë bazike humane.	Përkundër zotimeve formale dhe deklarative për lirinë e mediave, institucionet (ministra e brendshme, gjykatat dhe zyra e prokurorit) kanë dështuar të zgjidhin ndonjë rast që janë të regjistruara nga Asociacioni i Gazetarëve në 5 vitet e fundit.	Po. Ata fuqimisht dënojnë por deklarativisht, sepse kushtet nuk po ndryshojnë.	Zyrtarët publik dënojnë sulmet, por vetëm në raste serioze. Në përgjithësi, sulmet kundër gazetarëve njihen nga institucionet shtetërore si shkelje.	Shteti ka njohur nevojën për këtë (Plani i veprimit, Kapitulli 23, një pjesë e dedikuar lirisë së shprehjes, lirisë së pluralizmit të mediave), por afatet kohore nuk respektohen. Zyrtarët publik rrallë japin deklaratat të qarta në dënimin e sulmeve kundër gazetarëve.
A ekziston ndonjë dokument i adoptuar nga institucionet shtetërore të cilat japin udhëzime për ushtrinë dhe policinë dhe ndalojnë ngacmimin, frikësimin apo edhe sulmet fizike ndaj gazetarëve?	Janë dy udhëzime për zyrtarët policorë se sit ë sillen me gazetarë, e adoptuar para 15 viteve në bashkëpunim me misionin e OSBE-së.	Nuk ekzistojnë dokumente të tilla.	Nuk ekzistojnë dokumente të tilla.	Nuk ekzistojnë dokumente të tilla.	Nuk ekzistojnë dokumente të tilla. Draft memorandum është konsideruar si një përpjekje në këtë drejtim.
A bashkëpunojnë institucionet e shtetit me organizatat e gazetarëve rreth çështjeve të sigurisë së gazetarëve? A përmbahen institucionet e shtetit nga miratimi apo promovimi i kërcënimeve ndaj gazetarëve?	Në dy vitet e fundit, ekziston një bashkëpunim i mirë me Komisionin e të Drejtave të Njeriut në Parlament, ministria e të drejtave të njeriut dhe Agjencinë Rregullatore për Komunikim. Por, nuk ka reagim të kënaqshëm nga publiku nga institucionet shtetërore në rast të sulmeve dhe dhunës kundër gazetarëve.	Në përgjithësi, bashkëpunimi nuk është i mjaftueshëm. Institucionet vetëm formalisht kthejnë përgjigje në kërkesat zyrtare të dërguara nga AGM-së.	Nuk ekziston një bashkëpunim i tillë.	Bashkëpunimi nuk është në nivel të kënaqshëm.	Bashkëpunimi nuk është në nivel të kënaqshëm. Nuk ka bashkëpunim të rregulltë ndërmjet asociacioneve të gazetarëve dhe institucioneve shtetërore.

**C.2 A marrin përgjegjësi institucionet shtetërore dhe akterët politik për mbrojtjen e gazetarëve? (3 vite prapa)**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
Në raste të përgjimeve elektronik, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësi? Cili ka qenë rasti më i fundit të përgjimit elektronik ndaj gazetarit?	Nuk ka evidencë të besueshme për këto raste. Nuk ka mekanizma të duhura kontrolli ndaj trupave të cilat janë të autorizuar të zbatojnë mbikqyrjen elektronike. Rasti më i fundit: përgjimi i gazetarëve të magazinave Oslobodjenje dhe Dani, me urdhër të ish-drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Sigurisë (SIPA). Rasti i përgjimit të gazetarëve të cilët ishin në kontakt me ish-presidentin e BeH dhe publikuan transkriptet e bisedës me gazetarin e FTV-së Avdo Avdic.	Nuk ka mekanizma të duhura kontrolli ndaj trupave të cilat janë të autorizuar të zbatojnë mbikqyrjen elektronike. Në 2015 partia kryesore opozitare publikoi se më shumë se 100 gazetarë kanë qenë të nënshtruar ndaj mbikqyrjes jologjore në katër vitet e fundit (10% e gjithë gazetarëve në vend). Dokumentet e përgjimeve telefonike l janë dhënë 15 gazetarëve. Në emër të këtyre gazetarëve, AGM ka dorëzuar një padi penale.	Nuk ka evidencë të besueshme për këto raste. Nuk ka mekanizma të duhura kontrolli ndaj trupave të cilat janë të autorizuar të zbatojnë mbikqyrjen elektronike. Rasti i fundit: shkurt 2013 kur grupi i gazetarëve theksuan se ata ishin të ndjekur e të përgjuar në telefona.	Nuk ka evidencë të besueshme për këto raste. Nuk ka mekanizma të duhura kontrolli ndaj trupave të cilat janë të autorizuar të zbatojnë mbikqyrjen elektronike.	Nuk ka evidencë të besueshme për këto raste. Nuk ka mekanizma të duhura kontrolli ndaj trupave të cilat janë të autorizuar të zbatojnë mbikqyrjen elektronike. Rasti i fundit: Rjeti për Hulumtim të Krimit dhe Korrupsionit (KRRIK) dhe redaktorit të saj Stevan Dojcinovic.

**C.3 A merret në mënyrë efektive sistemi i drejtësisë penale dhe civile me kërcënime dhe akte të dhunës kundër gazetarëve? (3 vite prapa)**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A ekzistojnë institucione/njësi specifike të dedikuara në hetime, ndjekje, mbrojtje dhe kompensim në mënyrë që të sigurohet siguria e gazetarëve dhe çështja e mosndë-shkueshmërisë?	Nuk ekzistojnë institucione/njësi shtetërore të tilla. Ekziston vetëm Free Media Help Line e cila është themeluar nga asociacioni i gazetarëve të BeH.	Nuk ekzistojnë institucione/njësi të tilla.	Nuk ekzistojnë institucione/njësi të tilla. Një përgjashtim është Komisioni për monitorim të aktiviteteve të autoriteteve kompetente të rasteve të vjetra e të reja kundër gazetarëve, vrasjet e gazetarëve dhe sulmet në pronë të mediave.	Nuk ekzistojnë institucione/njësi të tilla.	Nuk ekzistojnë institucione/njësi të tilla. Një përgjashtim është Komiteti për shqyrtim të fakteve në lidhje me hetimin e vrasjeve të gazetarëve.
A ekzistojnë procedura special në vend që mund të merret me sulmet ndaj grave, përfshirë gazetaret gra?	Nuk ekzistojnë procedura të tilla. Prej 2013 gjer më shtator 2016 FMHL ka regjistruar 2 raste të kërcënimeve me vdekje, 3 sulme fizike dhe 23 sulme verbale/presione politike ndaj gazetarëve gra.	Nuk ekzistojnë procedura të tilla.	Nuk ekzistojnë procedura të tilla.	Nuk ekzistojnë procedura të tilla.	Nuk ekzistojnë procedura të tilla. Ekzistojnë disa raste të sulmeve ndaj gazetarëve gra (4 sulme fizike dhe 22 sulme verbale).

### C.3 A merret në mënyrë efektive sistemi i drejtësisë penale dhe civile me kërcënime dhe akte të dhunës kundër gazetarëve? (3 vite prapa)

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A ofrojnë agjencitë shtetërore burime adekuate për të mbuluar hetimet e kërcënimeve dhe veprave të dhunës kundër gazetarëve?	Burimet adekuate nuk janë ofruar nga institucionet e shtetit. Veprime dhe hetime efikase janë ndërmarrë nga zyret e policisë dhe prokurorit në Sarajevë në rastet e Lejla Colak (kërcënim me vdekje) dhe Borka Rudic (kërcënim verbal dhe gjuhë urrejtje) në korrik dhe gusht 2016.	Institucionet nuk ofrojnë ndonjë ndihmë efektive ligjore e statutore për gazetarë në rrjedhë të punës së tyre. Asnjë burim nuk është i alokuar për të hetuar kërcënimet apo aktet e dhunës.	Burimet adekuate nuk janë ofruar nga institucionet e shtetit. Hetimet janë shumë të ngadalta dhe me rezultate të dobëta.	Burimet adekuate nuk janë ofruar nga institucionet e shtetit. Kërcënimet kundër gazetarëve dhe qytetarëve trajtohen njësoj. Hetimet janë shumë të ngadalta.	Burimet adekuate nuk janë ofruar nga institucionet e shtetit. Hetimet janë shuëm të ngadalta dhe me asnjë rezultat.
A ofrohen masat e mbrojtjes për gazetarë kur kërkohen në përgjigje të kërcënimeve serioze kundrejt sigurisë së tyre fizike?	Shembuj të tillë nuk janë regjistruar.	Masa të tilla nuk janë dhënë. Ekzistojnë raste kur kundërvajtësit janë dokumentuar në video materiale. Në një rast madje zëvendës Kryeministri ishte fizikisht duke sulmuar një gazetar në një hapësirë publike e cila ishte inçizuar dhe publikuar, por ende institucionet nuk kanë ndërmarrë masa.	Në dy rastet më të rënda, dy sulme ndaj gazetarit Tufik Softic, shteti ka ofruar mbrojtje fizike për 24 orë, por problemi është se autorët e krimit nuk janë gjetur, kështu që arsyeja për të cilën u komprometua siguria e Softicit nuk është larguar.	Mbrojtja policore është ofruar për dy gazetarë (2104 dhe 2016) por të dy gazetarët konsideruan se nuk kanë nevojë për mbrojtje të afërt, kryesisht për arsye personale.	Disa masa janë dhënë, por ato varen nga rastet specifike. APGS ka informata për katër gazetarë që jetojnë 24/7 nën mbrojtje të policisë. Problemi më i madh me rastet e gazetarëve që janë të mbrojtur nga policia është se shteti nuk ndërmerr masa për të larguar kërcënimet aktuale.

**C.3 A merret në mënyrë efektive sistemi i drejtësisë penale dhe civile me kërcënime dhe akte të dhunës kundër gazetarëve? (3 vite prapa)**

Treguesit	Bosnja dhe Hercegovina	Maqedonia	Mali i Zi	Kosova	Serbia
A kryhen hetimet e krimit kundër gazetarëve, përfshirë frikësimin dhe kërcënimet, në mënyrë të shpejt, të pavarur dhe në mënyrë efektive?	Hetimet nuk janë efektive dhe nuk japi dëshmi të mjaftueshme. Procedurat në gjykata janë shumë të ngadalta. Sipas gazetarëve të BeH, vetëm 15% të rasteve kriminale janë hetuar dhe zgjidhur.	Bazuar në përvojën e AGM-së, hetimet e krimeve kundër gazetarëve nuk nisen dhe nëse kjo ndodh procesi është i ngadalhtë dhe pas mbyllje zyrtare të rastit.	Jo. Organizatorët janë të panjohur për secilin rast të madh, dhe një numër i madh i autorëve të krimit nuk janë gjetur. Hetimet nuk janë efektive dhe nuk japin dëshmi të mjaftueshme.	Jo. Tri vrasjet e pas lufës së gazetarëve ende nuk janë zgjidhur. Në përgjithësi, hetimet janë të ngadalta dhe jo efektive.	Jo. Të tri rastet e vrasjeve ende nuk janë zgjidhur. Hetimet nuk janë efektive dhe nuk japin dëshmi të mjaftueshme. Procedurat gjyqësore janë shumë të ngadalta.
A janë ndjekjet efektive në dhunën dhe frikësimin të kryera kundër zingjirit të plotë në sulme, përfshirë nxitësit/organizatorët dhe kryrësit e krimit?	Problemi më i madh është se akterët e vërtetë (politikanët, zyrtarët publik dhe individë të tjerë të fuqishëm) nuk ndiqen në asnjë rast. Po ashtu, akterët e vërtetë apo nxitësit në rastin e Zeljko Kopanja nuk janë zbuluar kurrë.	Jo.	Jo. Problemi më i madh është se akterët e vërtetë apo nxitësit nuk zbulohen kurrë. Në rastin e vrasjes së Dusko Jovanovic, vetëm një bashkëpunëtor është dënuar.	Jo. Nxitësit e vërtetë apo organizatorët nuk zbulohen kurrë.	Problemi më i madh është se akterët e vërtetë apo nxitësit nuk zbulohen kurrë. Rasti i gazetarit Curuvija dëshmon këtë.
A siguron Shteti se trajnime dhe kapacitete të duhura i ofrohen policisë, prokurorëve, avokatëve dhe gjyqtarëve për sa i përket mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe gazetarëve?	Disa forma të trajnimeve janë organizuar nga asociacione profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe nga organizatat mediale.	Nuk ka informacion për trajnime të tilla. Sidoqoftë, ekzistojnë raste të regjistruara ku kundërvajtësit janë anëtarë të policisë dhe këto incidente kanë zënë vend në demonstrate publike.	Disa forma trajnime janë organizuar në vitet e kaluara.	Asnjë trajnim nuk është siguruar nga shteti.	Disa forma të trajnimit janë organizuar viteve të kaluara. Edhe pse të planifikuara, forma të specializuara të trajnimeve ende nuk kanë nisur.





